



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
PROKURORIA THEMELORE / OSNOVNO TUŽILAŠTVO / BASIC PROSECUTION
PRIZREN – PRIZREN

AD.nr. 3/25

Dt. 03.03.2025

Prizren

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, duke vendosur lidhur me çështjen disiplinore të iniciuar pas pranimit të ankesës së [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], kundër prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, [REDAKTUAR], në bazë të nenit 9 par.1 pika 1.5 dhe par.6 të Ligjit Nr. 06/L – 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 par.3 nën par. 3.1 të Rregullores nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], kundër prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, [REDAKTUAR], sepse nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore nga neni 6 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L – 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Më datë 12.02.2025 përmes Këshillit Prokurorial të Kosovës, Autoriteti Kompetent ka pranuar një parashtrësë të trajtuar si ankesë nga [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] ndaj prokurores së Prokurorisë Themelore të Prizrenit nga Departamenti për të Mitur, [REDAKTUAR]

Dyshimet e para për shkelje disiplinore:

Dyshimet e para sipas parashtruesit në ankesës, janë pretendimet se prokurorja e Departamentit për të Mitur, [REDAKTUAR], gjatë kohës sa ka qenë prokurore pranë Departamentit të Përgjithshëm, në rastin [REDAKTUAR], ka punuar kundërligjshëm për shkak se është ndikuar nga pala tjetër dhe ka shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Për më tepër, parashtruesi i ankesës në shkresën e tij pretendon se prokurorja nën ndikimin e shefit të njësitit për krime ekonomike në Prizren dhe në shkelje procedurale, ka ngritur aktakuzë ndaj ankuesit për veprën penale "lajmërimi apo kallëzimi i rremë" nga neni 382 i KPRK-së. Përveç pretendimeve të lartcekura i njëjti ka pretenduar se para ngritjes së aktakuzës, prokurorja nuk ka marrë në pyetje të pandehurin dhe ka përdorur si provë dokumente joadekuate që kanë të bëjnë me shkeljet disiplinore në Policinë e Kosovës, të cilat pretendon se nuk janë të mjaftueshme për ngritje të aktakuzës. Për fund, është kërkuar që të hapet një hetim i detajuar për rolin e prokurores në këtë çështje penale, të shqyrtohet ligjshmëria e aktakuzës së ngritur, të vlerësohet përgjegjësia disiplinore dhe etike e prokurores.

Pasi që kemi pranuar këtë shkresë të njëjtën e kemi regjistruar në regjistrin e procedurave disiplinore dhe ka marrë numrin AD.nr.3/2025, për rastin në fjalë sipas procedurave është njoftuar Këshilli Prokurorial i Kosovës, përkatësisht kryesuesi i KPK-së, [REDAKTUAR]

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

Më datë 13.02.2025, është njoftuar Këshilli Prokurorial i Kosovës lidhur me regjistrimin dhe trajtimin e ankesës disiplinore.

Më datë 13.02.2025, Kryeprokurori konform nenit 6 par.2 të Rregullores nr.05/19 për Përgjegjësinë Disiplinore të Prokurorëve, ka kërkuar informata plotësuese për parashtruesin e ankesës [REDAKTUAR]

Më datë 13.02.2025, Kryeprokurori konform nenit 6 par.4 të Rregullores nr. 05/19 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, ka kërkuar nga prokurorja [REDAKTUAR] deklaratë lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës.

Më datë 14.02.2025, është pranuar deklaratën me shkrim nga prokurorja [REDAKTUAR].

Më datë 18.02.2025, është pranuar Njoftimin nga parashtruesi i ankesës [REDAKTUAR], në të cilën kanë qenë të përfshira përgjigjet në bazë të njoftimit të datës 13.02.2025.

Të gjeturat e rastit disiplinor:

Lidhur me këtë kërkesë, Autoriteti Kompetent ka kërkuar sqarime lidhur me rastin nga paraqitësi i ankesës [REDAKTUAR], gjithashtu sqarime ka kërkuar lidhur me rastin edhe nga prokurori i çështjes dhe ka analizuar shkresat e lëndës.

Sqarimet e paraqitësit të ankesës: nga përgjigja e datë 18.02.2025, e parashtruesit të kërkesës pretendohet se prokurorja e çështjes ka ngritur aktakuzë më datë 28.10.2020 për shkak të veprës penale “lajmërimi apo kallëzimi i rremë” nga neni 382 të KPRK-së, pa marrë deklaratë nga i akuzuari në kundërshtim me nenin 234 par.2 të KPP-së NR. 08/L-032. Parashtruesi i ankesës gjithashtu pretendon se prokurorja nuk ka vepruar në përputhje me nenin 239 par.1 e lidhur me par.5 të KPP-së, NR. 08/L-032, meqenëse të akuzuarin nuk e ka pajisur me kohë me shkresa të lëndës. Parashtruesi pretendon se provat në cilat është bazuar aktakuza nuk kanë të bëjnë për veprën penale e cila i vihet në barrë, por vetëm me punën e të akuzuarit në polici. I njëjti ka pretenduar se edhe dëshmitarët të cilët janë propozuar nga prokuroria nuk janë intervistuar në prokurori. Parashtruesi i ankesës në përgjigjen e tij ka kërkuar sqarime nëse është respektuar neni 239 par.5 të KPP-së NR. 08/L-032 në lidhje me atë se a është njoftuar kryeprokurori, kur prokurori i shtetit nuk përmbush detyrimet nga paragrafit 1 i këtij neni. Ndërsa sa i përket ndikimit që ka i dëmtuari në këtë rast [REDAKTUAR], pretendimet e ankuesit janë se i njëjti për shkak të pozitës si shef i sektorit të hetimeve dhe si zyrtar që merret me hetimet e rasteve për keqpërdorim të pozitës zyrtare, është në kontakt të përditshëm me prokurorinë dhe prokurorët, andaj ka dyshime serioze që ka ndikim edhe te prokurorja [REDAKTUAR].

Sqarimet e prokurorit të çështjes: nga përgjigja e prokurores së çështjes vërtetohet që e njëjta ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme procedurale në përputhje me dispozitat ligjore që kanë qenë në fuqi, për çka ka gjetur se ekzistojnë elementet e veprës penale “lajmërimi apo kallëzimi i rremë” nga neni 382 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] pranë Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti të Përgjithshëm për veprën e lartcekur bazuar në Kodin e Procedurës Penale nr.04/L-123. Prokurorja, në përgjigjen e saj ka specifikuar me data veprimet të cilat i ka ndërmarrë, duke përshtuar se kallëzimi ishte pranuar më datë 14.09.2020, më datë 28.10.2020 ishte bërë kërkesa për plotësim të kallëzimit penal dhe me datë 28.12.2020 ka ngritur aktakuzë të drejtpërdrejte bazuar në Kodin e Procedurës Penale nr.04/L-123. Sa i përket pretendimeve se prokurorja ka qenë e ndikuar nga shefi i Njësitit për Krime Ekonomike në Policinë e Kosovës në Prizren – i dëmtuari [REDAKTUAR] në përgjigjen e saj prokurorja e çështjes ndër të tjera ka theksuar me plotë siguri dhe bindje që të njëjtin nuk e ka njohur dhe nuk e njeh edhe sot, sepse nuk ka as raport familjar me të, e as profesional për faktin se që nga fillimi i punës e deri më tani nuk ka pasur ndonjë rast në trajtim me këtë njësit, andaj ka mohuar çfarëdo ndikimi të pretenduar. Po ashtu, prokurorja e çështjes, lidhur me pretendimet për përdorim të dokumenteve jo adekuate, në përgjigjen e saj ka specifikuar listën e dokumenteve të bashkangjitura në kallëzim penal nga i dëmtuari.

Autoriteti Kompetent, ka vërtetuar se lidhur me këtë çështje penale, më datë 14.09.2020 nga ana e palës [REDAKTUAR], është pranuar kallëzimi penal për të dyshuarin [REDAKTUAR], me pretendimet se i njëjti ka konsumuar elementet e veprës penale “Lajmërimi apo kallëzimi i rremë” nga neni 382 të KPRK-së, e cila lëndë në prokurori është regjistruar në regjistrin e

lëndëve me kryes të njohur dhe ka marr numrin fizik [REDACTED], numrin e smil: [REDACTED] dhe i ishte ndarë prokurores së shtetit [REDACTED].

Më datë 28.10.2020 prokurori i çështjes bazuar në nenin 83 par.4 të Kodit të Procedurës Penal 04/L-123, ka bërë kërkesë për plotësim të kallëzimit penale për parashtruesin [REDACTED].

Më datë 05.11.2020, nga parashtruesi i kallëzimit penal, prokurori i çështjes ka pranuar plotësimin e kallëzimit penal në të cilin plotësim janë bashkangjitur 12 shkresa/dokumente relevante.

Më datë 28.12.2020, prokurori i çështjes bazuar në nenin 49, 240, 241, 242 lidhur me nenin 101 par.2 të Kodit të Procedurës Penal 04/L-123 të Republikës së Kosovës, në lëndën me shenjën [REDACTED] ka ngritur Aktakuzë të drejtpërdrejtë, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se këtu i pandehuri [REDACTED] ka kryer veprën penale "lajmërimi apo kallëzimi i rremë" nga neni 382 i Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës.

Më datë 14.11.2023, pranë Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, është mbajtur shqyrtimi fillestar, në të cilin në mënyrë decitive është konstatuar "i akuzuari deklaron se e ka pranuar me kohë aktakuzën dhe se në tërësi e ka kuptuar të njëjtën". I akuzuari konform dispozitave të KPP-së është obliguar që gjykatës në afatin ligjor brenda 30 ditëve, t'i parashtroj kërkesën me shkrim për kundërshtimin e provave dhe hedhjen e aktakuzës.

Më datë 13.12.2023, Prokuroria Themelore në Prizren, ka pranuar përgjigjen e të akuzuarit në aktakuzën e prokurorit të shtetit.

Më datë 18.12.2023, Prokurori i çështjes pranë Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka dorëzuar përgjigjen ndaj kërkesës së mbrojtjes për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave.

Më datë 28.02.2024, Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, në lëndën nën shenjën [REDACTED], ka marr aktvendim përmes të cilit ka REFUZUAR si të pa bazuar kërkesën e të akuzuarit [REDACTED], për kundërshtimin e provave dhe hedhjen e aktakuzës, meqenëse ka konstatuar se kërkesa është e pa bazuar në ligj, përkatësisht në nenin 244 par.1 nën par. 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të KPPRK-së, si dhe provat nuk janë në kundërshtim me kapitullin XVII.

Më datë 17.07.2024, 03.09.2024, 26.09.2024, 07.11.2024, 17.12.2024, 03.02.2025, pranë Gjykatës Themelore në Prizren, janë mbajtur shqyrtimet kryesore.

Pretendimi i ankuesit se prokurorja ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale me rastin e ngritjes së aktakuzës ngase nuk ka marrë të pandehurin në pyetje, sqarohet në dispozitën e nenit 100 par.2 të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, sipas të cilës dispozitë kur policia apo ndonjë person tjetër bën kallëzim te prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një veprë penale ose për disa vepra penale, asnjëra nga të cilat nuk dënohet me më shumë se tre vjet burgim, dhe prokurori i shtetit vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën, prokurori i shtetit mund të ngrit aktakuzë sipas nenit 241 të këtij Kodi.

Është me rëndësi të konstatohet se në këtë çështje penale të trajtuar nën shenjën [REDAKTUAR] kallëzimi penal është parashtruar më datë 14.09.2020 dhe ka përfunduar me ngritje të aktakuzës më datë 28.12.2020. Siç mund të shihet dhe konstatohet, kjo çështje penale është trajtuar bazuar në kodin nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes dhe trajtimit të kësaj çështjeje penale (në fuqi deri më dt. 16.02.2023), ndërsa vlen të theksohet se ankesa e parashtruesit të kallëzimit penal është e bazuar në kodin nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, i cili ka hyrë në fuqi nga data 17.02.2023.

Vendimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, datë 28.02.2024, përmes të cilit është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e të akuzuarit [REDAKTUAR] për kundërshtimin e provave dhe hedhjen e aktakuzës, vërteton faktin se aktakuza e prokurorisë nuk është përfshirë në shkelje procedurale siç pretendon pala ankuese. Ndër të tjera në vendimin e gjykatës konstatohet se: *“pretendimet e të akuzuarit i hedh si të pabazuara për faktin se deri më tani ka prova të mjaftueshme të cilat e vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale, Lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 382 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, situata, ngjarja e paraqitur në aktakuzë mund të vërtetohet vetëm pas administrimit të provave për çka gjykata është e autorizuar që vlerësimin e provave ta bëjë gjatë shqyrtimit gjyqësor”*.

Pretendimet për ndikime te prokurorja e çështjes nga i dëmtuari i kësaj çështjeje, i cili është shef i NjHKEK-së, për asnjë moment dhe me asnjë provë nuk kanë mundur që të argumentohen, përkundrazi duke marrë parasysh që prokurorja e rastit në kohën kur ka ngritur aktakuzën ka qenë në filllet e punës së saj si prokurore dhe përgjatë kohës sa ka punuar në Departamentin e Përgjithshëm, kuptohet as në avancimin e saj në Departamentin për të Mitur, nuk ka pasur punë asnjëherë me të dëmtuarin e kësaj çështjeje, gjë të cilën nuk ka mundur ta argumentoj ankuesi edhe pse nga ana e autoritetit kompetent i është dhënë një mundësi e tillë me rastin e kërkesës për informata plotësuese. Andaj dyshimet e cekura si në ankesën e datës 07.02.2025 si dhe në përgjigjen e datës 18.02.2025, nuk vënë në dyshim punën e prokurores së çështjes, për faktin se në asnjërin prej parashtrësive të cilat janë dorëzuar nga parashtruesi i ankesës nuk është arritur të dëshmohet se prokurorja e çështjes lidhur me trajtimin e lëndës [REDAKTUAR], të këtë shkelur dispozitat ligjore në fuqi, apo të ketë vepruar nën ndikim të jashtëm.

Nga të lartcekurat, vlerësojmë se pretendimet e ankuesit janë të pa baza dhe nuk kanë të bëjnë me ndonjë shkelje disiplinore, eventualisht nëse do të vlerësohej niveli i dobët i aktakuzës mund të trajtohej (apo janë trajtuar në vitin 2020) në vlerësimin e performancës së prokurores e kurrsesi që pretendimet e tilla (përjashtuar pretendimet për ndikime nga jashtë) të trajtohen në aspektin disiplinor.

Konkluzioni:

Kryeprokurori si Autoritet Kompetent, nga të lartcekurat, pas vlerësimit dhe elaborimit në detaje si më lartë, si dhe pas analizimit të kësaj çështjeje disiplinore, nga deklarata e prokurorit të lartcekur, nga pretendimet e ankuesit, në veçanti nga shkresat e lëndës, ka konstatuar dhe vendosur se në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore nga neni 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, pasi që në bazë të shkresave të kësaj lënde konstatohet se prokurori i rastit i ka ndërmarrë të gjitha

veprimet e nevojshme dhe të domosdoshme ligjore konform dispozitave ligjore në fuqi dhe të gjitha veprimet e prokurorit kanë qenë profesionale dhe ligjore dhe në kuadër të fusheveprimtarisë funksionale dhe profesionale të prokurorit të shtetit, duke mos rënë ndesh për asnjë moment me kodin etik dhe sjelljen e pahijshme të prokurorit të shtetit.

. . .

Me sa u cek më lart u vendos si në dispozitiv të vendimit.

KRYEPROKURORI



T'i dorëzohet:

- [REDACTED]
- [REDACTED] *parashtrues i ankesës;*
- *Arkivës.*